



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KONKURS PËR PRAKTIKANTË

Komuna e Prishtinës shpall konkurs për **11 praktikantë nga Universiteti i Prishtinës** për periudhën **1 Qershor-30 nëntor 2016**. Praktikantët do të kompensohen me një bursë mujore,, e cila do të jetë në lartësi prej **100 euro**.

Aplikantët e suksesshëm do të sistemohen në Komunën e Prishtinës dhe do të angazhohen në Kabinetin e Kryetarit, përkatësisht Sektorin Ligjor (5+1 praktikantë) dhe Drejtorinë e Pronës (5 praktikantë).

Kushtet për Aplikim:

- student i Fakultetit juridik;
- viti i fundit i studimeve ose i sapo diplomuar;
- nota mesatare mbi 8.5;
- njohuri për Komunën e Prishtinës;
- njohuri nga procedura administrative;
- aftësi të mira komunikuese, me shkrim dhe me gojë;
- njohja e gjuhës angleze e preferueshme;
- pjesëmarrja në programet ekstra kurikulare dhe përvoja e punës, konsiderohet përparësi.

Aplikantët e suksesshëm duhet të paraqesin:

- një letër motivuese;
- CV/Resume dhe certifikatën e notave apo diplomën.
- një ese, në njërën nga këto tema: **“Fitimi dhe humbja e të drejtës së pronësisë” ose “Ankimi administrativ”** (600-1000 fjalë)
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk merret parasysh.

Në intervistë me gojë, ftohen vetëm aplikantët nga Lista e ngushtë, e cila hartohet mbi bazën e kriterëve të konkursit dhe vlerësimit të esesë dhe letrës motivuese.

Aplikacionet dërgohen në adresën elektronike mimoza.llapashtica@rks-gov.net ose në zyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore (Ndërtesa e vjetër e Komunës, Kati II, nr. 40), Rr. UÇK-2 Prishtinë, **më së largu deri më 19 Maj 2016, ora 16:00**. Të përzgjedhurit duhet të jenë të gatshëm për të filluar praktikën **nga dt. 1 Qershor 2016**.